


Projekti ne Gjirin e Lalezit

DUDAJ Konstruksion

2007 - 2011



Website: dudajkonstruksion.com
Rr. "Brigada VIII", Pall. Teknoprojekt,
Shk.1 ap.2/6
Tel. 04 23 1111
E-mail. info@dudajkonstruksion.com

Fshat Turistik, Hotel – Resort, Kompleks sportiv dhe argëtues në një të vetëm. Vetëm 35 km nga Tirana dhe po aq nga Aeroporti dhe Porti. Përgjatë bregdetit të Durrësit në një zonë tejet ekskluzive . Rrethuar nga nje gjerdan kodrash, buzë një bregdeti ranor dhe brenda një pylli me pisha , kompleksi privat ofron një siguri dhe relaks absolut. Doni t'i largoheni stresit, rrëmujes, pluhurit dhe problemeve të Tiranës: ky do të jetë vendi i parë që do t'ju bjerë ndër mend.



Tipi Projektit: Fshat Turistik, Hotel - Resort, Kompleks Rekreacioni në një të vetëm. Në një sipërfaqe totale prej 10 hektarë. Nga këto 6.1 ne pronësi private dhe 4 hektarë në përdorim dhe zhvillim.

Vendndodhja: Vetëm 35 km nga Tirana dhe po kaq nga Aeroporti dhe Porti. Përgjatë bregdetit të Durrësit në një zone tejet ekskluzive. Rrethuar nga një gjerdan kodrash, buze një bregdeti ranor dhe brenda një pylli me pisha, kompleksi privat ofron një siguri dhe relaks absolut.

Fshati Turistik: Ne një territor privat 51.000 m². Fshati ofron tere infrastrukturën e nevojshme të shërbimeve, pishine private, kënd lojërash për fëmijët etj. Janë 5 tipe banesash ne shitje:

- A - Vila Personale** : Total janë **15 Vila**. Sip. **Truallit 600 m²** Sip. **Ne kat 80 m²**
Sip. Tot. ndërtimi **240 m² (tre kate)** , Oborri **500 m²**
- B - Vila Dyshe** : Total janë **16 Vila**. Sip. **Truallit 350 m²** Sip. **Ne kat 75 m²**
Sip. Tot. ndërtimi **200 m² (tre kate)** , Oborri **250 m²**
- C - Vila Katërshe** : Total janë **72 Vila**. Sip. **Truallit 200 m²** Sip. **Ne kat 65 m²**
Sip. Tot. ndërtimi **125 m² (dy kate)** , Oborri **125 m²**
- D - Apar. Mbi Vila** : Ne Total **18 Apart**. Secili ndodhet ne kat te trete mbi vilaTip.....
Sip. Banimi **150 m²**, Veranda **100 m²**
- E - Apart. Kondomin** : Ne Total **67 Apart**, Sipërfaqe banimi qe variojne nga **40 – 120 m²**, Apartamente me oborr ose **verandë 30 – 60 m²**

Ps. Fshati Turistik është konceptuar si imobiliar (pra shitje) ai do menaxhohet nga e njëjta kompani si gjithë projekti. Ne total 188 njësi për t'u shitur. Varianti kur shitet dhe Hoteli 255 njësi

Hotel – Resort : Ngrihet në një territor 11.000 m². Godina në total kap një sipërfaqe prej 5000 m²
Ka rreth 100 dhoma Hoteli me një sip. Secila 30 m².
Në të përfshihen gjithashtu një restorant, 2 bare të brendshëm, 2 beach bare,
2 pool bare, një sallë lojërash, një sallë fitness, Sauna, etj.
Pishina me një kapacitet 150 persona. Parkimi për 50 makina etj.

Kompleksi Rekreativ : Është kompleksi më i madh për momentin, i llojit të tij, në vendin tonë.
Kompleksi shtrihet në një sipërfaqe 6 ha, nga të cilat 4 ha i zë kompleksi i lojërave dhe 2 ha plazhi.
Kompleksi i Lojërave përbëhet nga : Fusha e minigolfit e cila përbën dhe Risinë në këtë drejtim. Ajo është absolutisht e para e këtij sporti në Shqipëri. Gjithashtu ky kompleks përfshin dhe Fusha Tenisi, Fushe Multifunksionale (Futboll, Basket, Volej). Kompleksi i Lojërave për Fëmijë në një sip. 1.000 m².
Plazhi Dy beach bare, çadra për plazh ranor, ambiente ndihmëse, Beach Voley. etj
Lojëra uji si: varka për lundrim, skafe dhe motorra uji, zhytje.

Ps. Hotel Resort dhe Kompleksi Rekreativ janë konceptuar për: 1 – Sezoni Veror (pushime), 2 – Banorët e Fshatit dhe miqtë e tyre, po kështu dhe banorët e fshatrave të tjerë, 3 – Paketa Sportive dedikuar organizatave Qeveritare dhe Joqeveritare , Vendase dhe të Huaja, Kompanive të mëdha private etj. 4 – Klubeve Sportive dhe Ekipeve Kombëtare vendase dhe të huaj.

Hoteli ka një sipërfaqe ndërtimi 4.600 m² dhe shtrihet në një territor 10.000 m²

Arsyet pse duhet te zgjidhni Lalezin

1- Bregdet ende i virgjër vetëm 30 km nga Tirana.

Nëse qyteti është bërë i lodhshëm për ju dhe të paktën në fundjavë doni të “arratiseni” prej tij, nëse pluhuri-zhurma-rrëmuja ju kanë lodhur por puna nuk ju lë të largoheni dot shumë larg, nëse gjithmonë keni ëndërruar për një shtëpi në det por ju është dukur një ëndërr e largët, nëse keni një shtëpi në bregdet dhe jeni te pakënaqur prej saj por nuk kishit mundësi tjetër, tashmë përgjigjja për të gjitha dilemat tuaja erdhi. “ Arratisuni” në Kompleksin Turistik Lalëz vetëm 30 km nga Tirana dhe ëndrrat tuaja bëhen realitet. Plazhi i virgjër i cili shtrihet mes detit të kristaltë dhe pyllit të pishave. Peizazhi mahnitës rrethohet nga një kurorë kodrash të cilat duket se e ruajnë mrekullinë e perëndimit të diellit vetëm për vete.

2- Për herë të parë bëheni pronar dhe të truallit.

Hipotekë e garantuar në dorëzimin e viles, gjë që mundëson financimin nga Bankat. Kompleksi Turistik shtrihet në një tokë të blerë nga investitorët dhe do t'i kalojë në pronësi banorëve të vilave dhe apartamenteve. Duke dashur që gjithçka të jetë serioze dhe sa më afatgjatë po nisim një erë të re konceptimi dhe ndërtimi Turistik.

3- Jo vetëm shtëpi në plazh por dhe investim imobiliar me garanci absolute për rritjen e vlerës.

Në të njëjtën kohë ju kryeni tre transaksione, blini një shtëpi të dytë, siguronit pushimet dhe fundjavat në një ambient tejet ekskluziv, por dhe investoni në një vilë apo apartament që për vetë kohën dhe vendin e ndërtimit siguron rritjen e mëtejshme të vlerës.

4- Forma të ndryshme financimi.

Duke marrë parasysh dhe potencialet e tregut tonë financiar, kemi hyre në partneritet me disa banka të cilat sigurojnë kredi por dhe forma të tjera financimi me kushte tejet konkurruese për tregun tonë financiar. Gjithashtu kompania ofron paketa të ndryshme financiare ndër të cilat përmendim; Parapagim Me çelësa në dorë Porosi e veçantë etj

5- Një territor privat dhe i siguar me tërë ambientet e nevojshme infrastrukturore të shërbimeve por edhe pushimit.

Brenda territorit të rrethuar dhe ruajtur me roje private por dhe kamera sigurie, gjendet pishina e kompleksit, parkimi i makinave, kompleksi lodrave për fëmijë, minimarket etj. Në periferinë e tij ndodhet një Hotel i cili ofron dhoma, pishinë, restorant, bare, salle bilardo, sauna, fitness etj e cila ju

krijon mundësinë që kur keni miq, të ftuar apo dhe thjesht kërkonti më tepër gjallëri mund të shoqëroheni me njerëz të tjerë jo më larg se 200 m nga shtëpia juaj.

6- Projekt modern që vlerëson individin , komunitetin por dhe natyrën.

Vilat dhe Apartamentet janë projektuar duke pasur konceptin human në qendër të vëmendjes. Gjithçka është në funksion të njeriut. Lëndët e para dhe materialet e ndërtimit të cilat janë tejet cilësore por dhe punimet e kontrolluara rreptësisht nga një skuadër ekspertësh të fushës, garantojnë cilësinë e punimeve. Projekti ndan qartë sipas standardeve ndërkombëtare të administrimit bashkëkohor të drejtat dhe detyrimet në një komunitet. Në kontratën e shitjes përcaktohen saktë pronësia individuale dhe ajo kolektive, njëkohësisht administrimi i përbashkët i këtij projekti gjigand bën të mundur uljen e tarifave mujore të mirëmbajtjes.

7- Kompleks gjigand sportiv dhe argëtues.

Me pishina, fushë minigolfi, fusha tenisi, volejboll-basketbolli, minifutbolli, park lodrash për fëmijët, etj. Synimi ynë është që pushimet tuaja në çdo kohë të jenë sa më aktive. Ambienti sportiv përfshin një gamë të gjerë sportesh disa prej të cilëve vijjnë për herë të parë në Shqipëri dhe në këtë rast do të keni pranë dhe instruktoret përkatës. Duke marrë parasysh nevojat e fëmijëve për një kompleks lodrash por dhe të prindërve për një kohë përkushtimi ndaj vetes, jemi përpjekur që këndit të fëmijëve të mos i mungojë asgjë dhe në këtë mënyrë fëmijët mund të kalojnë orë të tëra në shoqërinë e njëri-tjetrit.

8- Plazh privat me lodra uji.

Duke e vlerësuar detin si një element tejet të rëndësishëm, kemi përfituar nga pastërtia e ujit dhe brezi i rërës (mbi 100m) të pashkelur, për të zhvilluar një pjesë të rëndësishme të projektit tonë në banjat e diellit (në një plazh privat) por dhe të lojërave të ujit në një det unik me thellësi ideale për të notuar, zhytur, lundruar etj.

Ekskluziv

Investim

Pronar Trualli

Financimi

Sport

Siguri

Plazh

Komunitet Bashkekohor